# LIGJ
# Nr. 93/2015
# PËR TURIZMIN[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

## KREU I

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt, dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse të sotme dhe të brezave të ardhshëm.

### Neni 2
### Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

1. Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike dhe përcaktimi i të drejtave e detyrimeve të subjekteve pjesëmarrëse në këto veprimtari, në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që lidhen me fushën e turizmit.

2. Rregullimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit e të ndërveprimit të organeve të qeverisjes qendrore me ato të qeverisjes vendore në përcaktimin e politikave dhe zhvillimit të strategjive në fushën e turizmit.

3. Përcaktimi i rregullave për bashkërendimin e punës dhe bashkëveprimin e institucioneve përgjegjëse në fushën e turizmit, me qëllim zhvillimin e industrisë së turizmit sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

4. Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe investitorëve potencialë, bazuar në interesin publik për zhvillimin e turizmit.

### Neni 3
### Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, që zhvillojnë veprimtarinë turistike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, veprojnë në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari turistike biznesi, në baza kontraktuale, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, për sa kohë që ato nuk bien në kundërshtim me ligjin e vendit ku zhvillohen këto veprimtari.

### Neni 4
### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Agjenci udhëtimi" është çdo person fizik ose juridik, i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si ndërmjetës, merr përsipër t'u ofrojë turistëve dhe personave të tjerë, si individë apo të organizuar në grup, çdo lloj shërbimi udhëtimi, përfshirë akomodimin në struktura pritëse për turistët, këshillimin dhe ofrimin e shërbimeve të udhëtimit me ajër, me tokë e me det, të ekskursioneve të organizuara, si dhe një sërë shërbimesh të tjera ndihmëse, që lidhen me industrinë e turizmit. Agjencia e udhëtimit zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në kontrata ndërmjetësimi për shitjen e shërbimeve të ofruara nga furnizuesit e shërbimeve të udhëtimit dhe/ose kontrata konsulence me konsumatorin.

---

*[1] Ky ligj është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me Aneksin e Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, "Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve", si dhe me nenin 2 dhe nenin 3 të Rregullores së Parlamentit Europian dhe Këshillit nr. 692/2011/BE, datë 6 korrik 2011, "Statistikat Europiane në Turizëm".*

2. “Agroturizëm” është veprimtaria pritëse që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulturore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtaritë e tjera ndihmëse që zhvillohen në atë mjedis bujqësor. Agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së ambientit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.

3. “Bujtinë” (shtëpi pritëse) është një ndërtesë, një pjesë e së cilës përdoret si rezidencë e pronarit dhe ku ofrohet akomodim dhe ushqim për turistët, përkundrejt pagesës.

4. “Burim turistik” është tërësia e elementeve dhe/ose faktorëve, si potenciale që mundësojnë prodhimin e një eksperience turistike, duke përfshirë burimet e prekshme, burimet e paprekshme si edhe burimet njerëzore.

5. “Certifikatë”, në kuptim të këtij ligji, është dokument i lëshuar nga ministria përgjegjëse për turizmin që shërben për të provuar plotësimin e kërkesave dhe standardeve për ushtrimin e veprimtarisë.

6. “Destinacion turistik” është pikë turistike me një përqendrim të lartë të produkteve turistike, i ngritur mbi bazën e studimeve dhe planeve të zonës dhe që ka kapacitete për të tërhequr vizitorë, vendas e të huaj, duke plotësuar e kënaqur kërkesat e tyre.

7. “Ekskursion” është kombinim i organizuar, paraprakisht, i shërbimeve të transportit dhe shërbimeve të tjera, që shiten ose ofrohen për shitje brenda të njëjtit çmim, shërbime që ofrohen për një periudhë më të shkurtër se 24 orë dhe që nuk përfshijnë akomodimin gjatë natës.

8. “Ekskursionist” është vizitori që udhëton për qëllime turizmi pa kaluar natën në vendin e vizituar.

9. “Fjetinë” (Hostel) është ndërtesë që ofron akomodim dhe ushqim me çmime ekonomike, zakonisht për udhëtarë, studentë dhe punëtorë, ku dhoma ndahet mes disa klientëve të ndryshëm.

10. “Fjetje dhe mëngjes (B&B)” është strukturë akomoduese që ofron shërbimin e fjetjes dhe mëngjesit brenda çmimit të dhomës. Kjo strukturë akomoduese nuk ofron shërbim restoranti dhe ambiente të përbashkëta.

11. “Fshat turistik tradicional” është vend i banuar me një përqendrim të lartë të burimeve dhe sipërmarrjeve turistike, i cili ka kapacitet për të tërhequr vizitorë vendas e të huaj, me një infrastrukturë të harmonizuar dhe mjedise që plotësojnë kërkesat e tyre.

12. “Hotel” është ndërtesë me jo më pak se 6 dhoma, ku akomodimi dhe shërbime si ushqim, pije etj. ofrohen nga një staf i kualifikuar, kundrejt një çmimi të afishuar.

13. “Industri turistike” është tërësia e bizneseve që ofrojnë shërbime dhe lehtësi të tjera në funksion të fushës së turizmit.

14. “Kamping” është zonë publike ose private e rrethuar, e pajisur me infrastrukturë të domosdoshme (ujë, tualete, energji elektrike etj.), ku udhëtarët mund të akomodohen në tendat e kampingut, apo të ngrenë tendat e tyre, ose të parkojnë mjetin motorik akomodues (kamper).

15. “Kamper” është mjet motorik i pajisur me kushte të përshtatshme qëndrimi, për ushtrimin e një aktiviteti turistik që ruan aftësinë e përhershme të mjetit lëvizës për t’u zhvendosur në çdo kohë.

16. “Licencë” është akti administrativ i përcaktuar sipas dispozitave të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

17. “Ministria përgjegjëse për turizmin” është ministria që ka si fushë përgjegjësie turizmin.

18. “Motel” është ndërtesë që ofron shërbim akomodimi dhe parkimi, zakonisht me synimin për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve, me vend-ndodhje në periferi të qendrave të banuara, pranë kryqëzimeve dhe rrugëve automobilistike.

19. “Ofruesi i shërbimeve turistike” është sipërmarrja turistike e transportit, akomodimit, argëtimit dhe e të gjitha shërbimeve të tjera për kalimin e kohës së lirë.

20. “Operatori turistik” është personi fizik dhe juridik që zhvillon një veprimtari tregtare, e cila ka të bëjë me dizenjimin dhe organizimin e një udhëtimi/pakete të paraplanifikuar e të promovuar me anë të katalogëve, fletëpalosjeve, reklamave në TV etj., duke qenë përgjegjës për atë produkt, si në rastin e shitjes nëpërmjet agjencive të udhëtimit, ashtu edhe në rastin e shitjes së drejtpërdrejtë te klienti. Operatori turistik nënshkruan kontrata drejtpërdrejt me furnizuesit e shërbimeve turistike, duke i parablerë këto shërbime.

21. “Paketë udhëtimi” është kombinimi paraprak i jo më pak se dy llojeve të shërbimeve të udhëtimit, si transport e akomodim, ose çdo shërbim turistik për qëllim të të njëjtit udhëtim apo

pushim, për më shumë se 24 orë, nëse:

a) këto shërbime janë kombinuar nga një operator turistik i licencuar, me kërkesën apo me zgjedhjen e shërbimeve prej turistit, përpara përfundimit të kontratës së lidhur me këtë kombinim shërbimesh; ose

b) pavarësisht nëse janë mbyllur kontrata të veçanta me ofrues të shërbimeve turistike të veçantë, këto shërbime:

i) shiten në të njëjtën pikë shitjeje, nëpërmjet një procesi rezervimi të njëjtë;

ii) ofrohen ose shiten me një çmim të vetëm;

iii) publikohen ose shiten me emërtimin "paketë" ose me një emërtim të ngjashëm me të;

iv) kombinohen pas mbylljes së kontratës, me anë të së cilës operatori turistik i jep të drejtën udhëtarit të zgjedhë midis opsioneve të ndryshme të shërbimeve të udhëtimit; ose

v) blihen prej ofruesve të licencuar të shërbimeve, nëpërmjet proceseve të lidhura rezervimesh elektronike, ku emri dhe të dhënat e tjera të udhëtarit, të domosdoshme për mbylljen e rezervimit, i kalojnë ofruesve të tjerë të shërbimeve në fjalë, jo më vonë se sa koha kur konfirmohet shërbimi i parë.

22. "Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit" është plani i hartuar në përputhje me ligjin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe strategjinë kombëtare të zhvillimit të turizmit, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

23. "Produkt turistik" është tërësia e elementeve të ndërthurura, që organizohet si vlerë e veçantë zinxhir, e cila përmban produkte materiale dhe shërbime, vlera natyrore dhe kulturore, superstrukturë dhe infrastrukturë turistike.

24. "Punë artizanale" janë punë të bëra me dorë, me interes kulturor e historik, të prodhuara për shitje për turistët që përfshijnë punime druri, punime argjendi, qëndistari, punime në llak/vernik, prodhime xhami, kostume, gdhendje, punime guri, piktura, qeramikë, shportari dhe ndonjë lloj tjetër punimi të emërtuar si i tillë.

25. "Qendër kurative" është strukturë akomoduese me vendndodhje në zona me potenciale kuruese natyrore, të cilat stimulohen nga toka, uji, deti, rëra e klima dhe që shërbejnë për kryerjen e terapive kuruese.

26. "Regjistri Qendror i Turizmit" është regjistri publik i sipërmarrjeve turistike që mbahet sipas parashikimeve të këtij ligji dhe që ka qëllime statistikore.

27. "Regjistri kombëtar i burimeve turistike" është sistem informacioni që përmban një bazë të dhënash mbi burimet turistike të vendit.

28. "Resort" është kompleks ndërtesash për pushim dhe argëtim, të grupuara e të administruara së bashku, si hotele, apartamente, vila, studio, që u ofron klientëve akomodim, ushqim, pije, veprimtari sportive e argëtuese dhe shërbime ndihmëse, nëpërmjet një stafi të kualifikuar.

29. "Shërbim turistik" është lehtësia që u ofrohet turistëve nga sipërmarrja turistike.

30. "Shoqërues udhëtimi" është person i punësuar apo i kontraktuar nga një agjenci udhëtimi apo operator turistik për të drejtuar një udhëtim apo një ekskursion. Teknikisht, shoqëruesi i udhëtimit kryhen vetëm shoqërimin e grupit turistik, pa ushtruar funksionin e udhërrëfyesit turistik.

31. "Sipërmarrje turistike" është veprimtari turistike e ndërmarrë nga personi fizik ose juridik, e krijuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

32. "Stacion plazhi" është veprimtari turistike e ushtruar në struktura të ndodhura pranë bregut të detit, të liqeneve ose lumenjve, të pajisura me kabina për plazh, dhoma zhveshjeje, shërbime higjienike, dushe që, sipas rastit, ofron shërbimin e ushqimit dhe pijeve.

33. "Strukturë akomoduese" është struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera), në përputhje me standardet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj.

34. "Suvenire" janë mallra, harta, fotografi, kartolina dhe mallra të tjera të këtij lloji, të ndryshme nga ato të bëra me dorë, që u shiten turistëve si kujtim të vizitës së tyre në Shqipëri.

35. "Timeshare", i njohur, gjithashtu, si pronësi pushimesh, lejon blerësit të blejnë kohë ose kredite pushimi në njësi të strukturës akomoduese. Pronësia e pushimeve ndahet midis individëve, në bazë të kohës, me intervale javore. Ky produkt pushimi i parapaguar mundëson akomodimin për pushime të ardhshme me çmimin e sotëm.

36. "Turist" është vizitori që qëndron, të paktën për një natë, në vendin që vizitonpër pushim,

biznes dhe qëllime të tjera.

37. "Turizëm" është tërësia e veprimtarive të personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë, për jo më shumë se 1 vit, në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm, për pushim, biznes dhe qëllime të tjera që nuk kanë lidhje me ushtrimin e ndonjë veprimtarie të paguar në vendin që vizitohet.

38. "Turizëm i qëndrueshëm" është turizmi që përmbush nevojat e turistëve, të komuniteteve pritëse, të sipërmarrjeve turistike dhe të vendimmarrësve lokalë e qendrorë, nëpërmjet menaxhimit të burimeve turistike, ruajtjes së vlerave të vazhdueshme ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, me qëllim që ato të mbeten po aq tërheqëse sa më parë dhe të krijohen mundësi për zhvillimin e turizmit në të ardhmen.

39. "Turizëm kombëtar" nënkupton turizmin vendas dhe turizmin në dalje.

40. "Turizëm ndërkombëtar" nënkupton turizmin në dalje dhe turizmin pritës.

41. "Turizëm vendas" është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori rezident brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

42. "Turizëm pritës" është tërësia e veprimtarive turistike, të vizitorëve rezident dhe jorezident, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

43. "Turizëm në hyrje" është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori jo rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë.

44. "Turizëm në dalje" është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori rezident jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

45. "Turizëm rural", veprimtaria turistike që zhvillohet në një mjedis fshati dhe që është e orientuar drejt përdorimit të burimeve lokale të turizmit.

46. "Udhërrëfyes turistik" është çdo person, mbi moshën 18 vjeç, i certifikuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas parashikimeve të këtij ligji, i cili ofron asistencë, informacion dhe interpretime të trashëgimisë kulturore, historike e bashkëkohore për një grup të organizuar turistësh ose individë të veçantë, në një mjedis turistik, qoftë ky qytet, fshat, rrethinë me interesa të veçantë turistikë, muze apo ndërtesa të tjera me vlera edukuese, fetare, historike dhe kulturore.

47. "Udhëtar" është individi që lëviz ndërmjet vendeve të ndryshme, jashtë vendbanimit të zakonshëm, për arsye dhe kohëzgjatje të ndryshme.

48. "Veprimtari turistike" është tërësia e veprimtarive që zhvillohen në bazë të kërkesës dhe ofertës, në fushën e turizmit, dhe prodhon produkte karakteristike të turizmit.

49. "Vizitor" është çdo person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendbanimi i vet i zakonshëm, për më pak se 1 vit, dhe që nuk ka si qëllim të ndërmarrë veprimtari që paguhen në vendin e vizituar.

50. "Vizitor ditor" është personi që viziton përkohësisht një vend dhe qëndron për më pak se 24 orë, me qëllimin e kalimit të kohës së lirë apo të biznesit, por jo për transit.

51. "Zonë me përparësi zhvillimin e turizmit" është zonë me rëndësi kombëtare në fushën e turizmit, e cila miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

52. "Zyrë e informacionit turistik" është zyrë, qëllimi parësor i së cilës është t'u sigurojë turistëve informacion lidhur me udhëtimet, veprimtaritë dhe objektet turistike, aktivitetet kulturore dhe çështje të tjera, për të lehtësuar vizitën, udhëtimin apo qëndrimin e tyre.

## KREU II
## PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË TURIZMIT DHE INVESTIMET NË ZHVILLIMIN E TIJ

### Neni 5
### **Parimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit**

1. Turizmi dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me të mbështeten në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Këto parime kanë të bëjnë me aspektet ekonomike, mjedisore e social-kulturore dhe kërkojnë vendosjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet këtyre tri dimensioneve, për të siguruar qëndrueshmërinë e zhvillimit afatgjatë.

2. Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit sigurohen nëpërmjet:

a) përfshirjes së organeve të ndryshme publike, të sektorit privat, shoqatave profesionale, tregtare e të mbrojtjes së konsumatorit, të OJF-ve përkatëse, si dhe të popullsisë në procesin e planifikimit;

b) organizimit dhe zbatimit të planifikimit turistik në nivel vendor, në përputhje me Planin Kombëtar të Turizmit, të hartuar dhe të miratuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, si pjesë përbërëse e

zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në nivel kombëtar;

c) parashikimit, planifikimit, administrimit dhe kontrollit turistik, duke respektuar mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve turistike, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara për përdorimin e tyre;

ç) shpërndarjes së drejtë të avantazheve dhe të kostove ndërmjet të gjithë aktorëve të sistemit turistik;

d) informimit, arsimimit, motivimit dhe përfshirjes së popullsisë vendase në procesin e krijimit të vlerës për turistin;

dh) vlerësimit paraprak të projekteve të turizmit dhe ndikimit që do të ketë zbatimi i tyre;

e) përfshirjes së komuniteteve lokale në studimin dhe hartimin e programeve të përbashkëta për zhvillimin e turizmit;

ë) monitorimit të zbatimit të projekteve të turizmit.

Neni 6

**Investimet në zhvillimin e turizmit dhe interesi publik**

Zhvillimi i turizmit, nëpërmjet investimeve vendase apo të huaja, në zbatim të këtij ligji, konsiderohet interes publik, duke gëzuar të gjithë mbështetjen dhe lehtësitë e parashikuara në kreun VI të këtij ligji.

KREU III

KUADRI INSTITUCIONAL DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN

Neni 7

**Politikat shtetërore për turizmin**

1. Institucionet shtetërore si dhe strukturat përgjegjëse për turizmin mbështetin fushën e turizmit, si një sektor kryesor gjithëpërfshirës ekonomik, ndërsektorial dhe ndërrajonal, duke e shndërruar atë në një fushë udhëheqëse në ekonomi, nëpërmjet përmbushjes së kërkesave të turistëve vendas e të huaj për vizita, pushime, çlodhje dhe argëtim, me synimin për të rritur punësimin dhe zhvillimin social e ekonomik të vendit.

2. Drejtimet kryesore të politikës shtetërore në fushën e turizmit, që bazohen te parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, janë, si më poshtë:

a) njohja e turizmit si sektor prioritar i ekonomisë;

b) mbështetja e veprimtarive turistike dhe krijimi i kushteve të favorshme ligjore, ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tyre;

c) përcaktimi i drejtimeve prioritare për zhvillimin e turizmit në Shqipëri;

ç) krijimi i imazhit të Republikës së Shqipërisë si destinacion turistik;

d) krijimi i kushteve për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të turistëve e të ofruesve të shërbimeve të turizmit;

dh) garantimi i zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit;

e) mbështetja dhe bashkëpunimi i organizatave /shoqatave të turizmit në mënyrën e përcaktuar nga ligji;

ë) zhvillimi dhe mbështetja e turizmit pritës.

Neni 8

**Organet përgjegjëse në fushën e turizmit**

Organet përgjegjëse në fushën e turizmit janë:

a) ministria përgjegjëse për turizmin;

b) Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit;

c) Agjencia Kombëtare e Turizmit;

ç) Agjencia Kombëtare e Bregdetit;

d) degët territoriale të turizmit;

dh) inspektorati që mbulon fushën e turizmit;

e) njësitë e qeverisjes vendore;

ë) komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike.

Neni 9

**Ministria përgjegjëse për turizmin**

1. Ministria përgjegjëse për turizmin ka këto detyra:

a) zbaton parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e industrisë turistike;

b) harton dhe paraqet për miratim, pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, Planin Kombëtar të Turizmit dhe përgjigjet për zbatimin e tyre;

c) harton dhe paraqet për miratim, pranë Këshillit të Ministrave, strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe planin e veprimit;

ç) krijon dhe administron Regjistrin Qendror të Turizmit dhe Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike;

d) mbështet dhe bashkëpunon me grupet e interesit në procesin e studimit të tregut, lidhur me burimet dhe produktet turistike, zhvillimin e tyre në përputhje me kërkesat e tregut turistik dhe konkurrencën në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit;

dh) mbështet financiarisht projektet që ndihmojnë zhvillimin e fushës së turizmit;

e) mbështet, mbron e zhvillon burimet turistike dhe promovon produktet turistike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe në bashkëpunim me grupet e interesit;

ë) merr masa për mbarëvajtjen, mbrojtjen dhe nxitjen e punësimit në industrinë e turizmit, duke i dhënë prioritet punësimit të të rinjve;

f) nxit, mbështet e promovon edukimin dhe formimin profesional të vazhdueshëm turistik, nëpërmjet institucioneve dhe programeve të akredituara, sipas legjislacionit në fuqi, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse që mbulojnë fushën përkatëse;

g) nxit, mbështet dhe bashkëpunon me institucione publike dhe private në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave në fushën e turizmit;

gj) bashkërendon punën për zbatimin e dispozitave ligjore, përfshirë konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e turizmit;

h) përfaqëson interesat e Qeverisë pranë organizatave të ndryshme ndërkombëtare, në pajtim me traktate dhe marrëveshje të tjera të nënshkruara nga Qeveria, dhe bashkëpunon me këto organizata e me shtete të tjera;

i) harton dhe zbaton politikat për sistemet e certifikimit dhe klasifikimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

j) bashkëpunon me organizata ndërkombëtare që veprojnë në fushën e turizmit për programet e asistencës që ato ofrojnë;

k) i propozon Këshillit Kombëtar të Territorit miratimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

l) bashkëpunon me autoritetet kompetente për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e vizitorëve vendas apo të huaj;

ll) promovon dhe ndjek zbatimin e Kodit Global të Etikës në Turizëm;

m) harton politikat e zhvillimit të produktit turistik dhe marketingut në fushën e turizmit, bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit dhe Strategjinë Kombëtare të Marketingut për sektorin e turizmit;

n) përcakton kriteret për funksionimin e zyrave të informacionit turistik;

nj) bashkërendon punën me institucionet përgjegjëse për pajisjen e infrastrukturës rrugore dhe inxhinierike me sinjalistikën turistike, mbrojtjen e integruar të mjedisit, mbrojtjen nga ndërhyrjet e paligjshme dhe dëmtimet në zonat turistike;

o) luan rol koordinues lidhur me zbatimin e politikave të zhvillimit të produktit turistik dhe menaxhimit të destinacionit;

p) administron çdo ankesë të shtetasve, vendas apo të huaj, ndaj hotelierëve, pronarëve të resorteve turistike, udhërrëfyesve turistikë, agjencive të udhëtimit, operatorëve turistikë dhe sipërmarrjeve të tjera turistike për shërbimet e ofruara, dhe ia përcjell për shqyrtim inspektoratit që mbulon fushën e turizmit;

q) harton programe për mbështetjen e projekteve turistike;

r) mbështet, nxit dhe ndërgjegjëson sipërmarrjet turistike, që ushtrojnë veprimtari turistike si strukturë akomoduese, lidhur me përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore dhe certifikimin “Eco-Certifikatë”.

2. Çdo institucion publik qendror dhe vendor, si edhe çdo organizatë jofitimprurëse në Shqipëri, që përfshihet në programet e asistencës së ofruar nga organizatat ndërkombëtare të lidhura me turizmin, njofton ministrinë për veprimtarinë që kryen, sipas një formati të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin dhe të publikuar në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Neni 10

**Dega territoriale e shërbimit të turizmit**

1. Dega territoriale e shërbimit të turizmit krijohet si një strukturë administrative e ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të degës territoriale të shërbimit të turizmit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Dega territoriale e shërbimit të turizmit, në zbatim të këtij ligji, kryen këto funksione:

a) koordinon punën në terren për zbatimin e politikave të zhvillimit të produktit turistik dhe të menaxhimit të destinacionit turistik;

b) këshillon sipërmarrjet turistike për përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve turistike të ofruara;

c) nxit dhe ndërgjegjëson sipërmarrjet turistike dhe komunitetet pritëse për edukimin në vazhdim;

ç) jep informacion për sipërmarrjet turistike, lidhur me kuadrin ligjor dhe standardet në fushën e turizmit, si dhe shpërndan manualet e klasifikimit /certifikimit për sipërmarrjet turistike;

d) këshillon palët e interesuara për ngritjen e sipërmarrjeve turistike;

dh) regjistron çdo kërkesë dhe ankesë që paraqitet nga turistët, përfaqësues të tyre dhe nga shoqatat konsumatore dhe ia përcjell ato inspektoratit që mbulon fushën e turizmit;

e) bashkëpunon me autoritetet vendore për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e turistit në destinacion;

ë) bashkëpunon me autoritetet vendore dhe grupet e interesit për të siguruar informacione në fushën e turizmit, sipas kërkesave dhe detyrave të dhëna nga struktura përgjegjëse për turizmin;

f) bashkëpunon me bizneset turistike për evidentimin dhe vlerësimin e nevojave për trajnime, për përmirësime ligjore e procedurale;

g) mbledh të dhëna dhe harton raporte periodike, në bashkëpunim me nëpunësit e turizmit të njësive të qeverisjes vendore, të cilat ia paraqet strukturës përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për turizmin.

Neni 11

**Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit**

1. Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit, në vazhdim KKSPT, krijohet si një organ këshillimor për sektorin e turizmit.

2. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të KKSPT-së përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

3. KKSPT-ja kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe në përbërje të tij ka përfaqësues nga shoqatat kombëtare të sipërmarrjeve, që operojnë në fushën e turizmit apo të lidhura me to, përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, dhomat e tregtisë, përfaqësues të shoqatave apo OJF-ve, që operojnë në fushën e turizmit, si dhe përfaqësues të institucioneve /donatorë ndër-kombëtarë.

4. KKSPT-ja ka këto detyra:

a) këshillon ministrin përgjegjës për turizmin për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit përpara miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave;

b) trajton dhe shqyrton çështje që kanë lidhje me veprimtarinë turistike të sektorit privat ose që mund të dalin gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie;

c) siguron bashkëpunim ndërmjet sektorit privat dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin për çështje që mund të lindin gjatë zhvillimit të turizmit, zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit dhe Planit të Veprimit;

ç) jep mendime mbi planifikimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;

d) jep mendime gjatë shqyrtimit të akteve ligjore që kanë lidhje me turizmin;

dh) jep informacione për ecurinë e sektorit privat të turizmit dhe i sugjeron ministrisë përgjegjëse për turizmin marrjen e masave për çështje që kanë të bëjnë me turizmin.

Neni 12

**Agjencia Kombëtare e Turizmit**

1. Agjencia Kombëtare e Turizmit, në vijim AKT, është personi juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin, që ka për qëllim promovimin e turizmit shqiptar, brenda dhe jashtë vendit. AKT-ja e ka selinë në Tiranë.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të AKT-së miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Struktura dhe organika e AKT-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 13

**Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit**

Drejtori i Përgjithshëm i AKT-së drejton veprimtarinë e përditshme të saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët. Ai ushtron të gjitha kompetencat për drejtimin e veprimtarisë së AKT-së. Emërimi dhe lirimi i Drejtorit të Përgjithshëm të AKT-së bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 14

**Funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Turizmit**

Agjencia Kombëtare e Turizmit ka këto funksione dhe kompetenca:

1. Zbaton politikat e marketingut në fushën e turizmit, duke promovuar turizmin shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar.

2. Ofron informacion për vizitorët, udhëtarët dhe turistët, për shërbimet turistike që ofrohen, për produktet dhe destinacionet turistike, për veprimtari e të dhëna të tjera të dobishme.

3. Promovon produktin dhe destinacionet turistike brenda e jashtë vendit, duke bashkëpunuar me zyrat rajonale të turizmit, pushtetin vendor dhe organizma të tjerë që operojnë në fushën e turizmit.

4. Promovon investimet në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera publike të nxitjes së investimeve në vend.

5. Inicion dhe nxit projekte për turizmin, sipas fushës së vet të veprimtarisë, duke marrë miratimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

6. Propozon dhe harton materialet me karakter promocional, në përputhje me tendencat e tregut turistik, dhe realizon prodhimin e tyre.

7. Zbaton strategjinë kombëtare të zhvillimit të turizmit dhe strategjinë kombëtare të marketingut për sektorin e turizmit.

8. I propozon ministrit përgjegjës për turizmin ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e turizmit, duke argumentuar arsyet që lidhen me këto propozime.

9. Monitoron, përmirëson dhe përditëson faqen zyrtare të promocionit të turizmit shqiptar.

10. Mbledh të ardhurat që realizohen nga marrëveshjet e qirasë, për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit, dhe bën derdhjen e tyre në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

11. Kontrollon zbatimin dhe plotësimin e kritereve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe për marrëveshjet e zhvillimit, të lidhura me subjektet "person i stimuluar".

Neni 15

**Agjencia Kombëtare e Bregdetit**

1. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në vijim AKB, është person juridik publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin, që ka për qëllim mbrojtjen dhe ndjekjen e zhvillimit të zonës bregdetare shqiptare.

2. Kompetencat, mënyra e organizimit dhe funksionimit të AKB-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Struktura dhe organika e AKB-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 16

**Inspektorati në fushën e turizmit**

1. Inspektorati që mbulon fushën e turizmit, në vijim Inspektorati, është personi juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin. Inspektorati funksionon sipas këtij ligji dhe ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

2. Inspektimi i veprimtarive turistike ka si qëllim të sigurojë zbatimin e legjislacionit të turizmit nga subjektet mbi të cilat vepron ky ligj, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit.

3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Struktura dhe organika e Inspektoratit miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 17

**Funksionet dhe kompetencat e Inspektoratit**

1. Inspektorati, në zbatim të këtij ligji, kryen këto funksione:

a) kontrollon zbatimin e kritereve dhe kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;

b) kontrollon dhe inspekton mjediset ku realizohet veprimtaria turistike;

c) bashkëpunon dhe u jep informacion organeve të tjera shtetërore, për rastet që janë në kompetencë të tyre, në lidhje me veprimtarinë turistike;

ç) kontrollon dhe merr masat për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) mbledh dhe administron dokumentacionin e plotë përkatës, përfshirë dokumente elektronike, të cilat kanë të bëjnë me objektin e kontrollit;

dh) ushtron kontroll në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve turistike, të cilat kanë detyrimin të lejojnë dhe të vënë në dispozicion të Inspektoratit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për inspektim;

e) vendos gjoba dhe masa të tjera administrative ndaj personave fizikë a juridikë, kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji.

2. Inspektorati shqyrton ankesat ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike, të marrë drejtpërdrejt ose të përcjellë nga çdo institucion tjetër apo individ.

3. Inspektorati merr vendim, pas shqyrtimit të ankesave, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe në përputhje me kompetencat e dhëna me këtë ligj.

4. Rregullorja e shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 18
**Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike**

1. Për certifikimin e veprimtarive turistike, për dhënien dhe revokimin e certifikatave përkatëse ngrihet komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike, pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Mënyra e organizimit, e funksionimit dhe përbërja e komisionit të standardizimit të veprimtarive turistike përcaktohet me rregullore të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin dhe përbëhet nga 5 anëtarë.

Neni 19
**Njësitë e qeverisjes vendore, detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e turizmit**

Njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të këtij ligji, kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të krijojnë inventarin e burimeve kryesore turistike të njësisë së qeverisjes vendore dhe inventarin e sipërmarrjeve turistike në nivel vendor;

b) të përcjellin, periodikisht, çdo 6 muaj, inventarët e përmendur në shkronjën “a”, të këtij neni, pranë ministrit përgjegjës për turizmin, për krijimin e bazës së të dhënave në nivel kombëtar;

c) të sigurojnë infrastrukturën mbështetëse për veprimtaritë e biznesit të turizmit në nivel vendor, duke mundësuar respektimin e standardeve nga sipërmarrjet turistike;

ç) të kontribuojnë në zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në nivel vendor, si turizmi kulturor, agroturizmi etj., në bazë të burimeve turistike, duke luajtur rol aktiv në diversifikimin e produktit turistik, në bashkëpunim me të gjitha institucionet qendrore e vendore, si dhe grupet e interesit;

d) të sigurojnë informacion, si pjesë e sistemit të statistikave të turizmit, për ministrin përgjegjës për turizmin;

dh) të bashkëpunojnë për marrjen e masave për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor parësor për vizitorët/turistët, brenda juridiksionit të njësisë së pushtetit vendor, duke zbatuar standardet e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe ajo e shëndetësisë;

e) të marrin masa për krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm brenda juridiksionit të territorit të tyre, në përputhje me normat dhe në zbatim të rregulloreve higjieno-sanitare.

Neni 20
**Komiteti rajonal i zhvillimit të turizmit**

1. Me qëllim bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore, për çështjet e turizmit, pranë çdo prefekture krijohen komitetet rajonale të zhvillimit të turizmit, nën drejtimin e prefektit të qarkut. Në përbërje të këtyre komiteteve janë përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore, përfaqësues të qarkut, përfaqësues të shoqatave lokale në fushën e turizmit, institucioneve arsimore dhe edukuese për turizmin dhe përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Komiteti rajonal i zhvillimit të turizmit ka për detyrë:

a) të sigurojë një forum për të trajtuar çështjet që lidhen apo që lindin nga veprimtaritë turistike në njësitë e qeverisjes vendore;

b) të sigurojë një forum për bashkëpunim, ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe institucioneve të tjera

të turizmit në nivel vendor, për çështjet që lindin në fushën e zhvillimit të turizmit, në zbatimin e politikës kombëtare dhe për çështje të tjera të lidhura me këtë fushë;

c) të sigurojë informacion për ministrin dhe AKT-në, për çështjet e lidhura me turizmin, që krijohen në njësitë e qeverisjes vendore, sipas territorit administrativ përkatës.

3. Komiteti mblidhet, të paktën, dy herë në vit dhe në çdo rast tjetër që kërkohet nga prefekti.

4. Organizimi dhe funksionimi i komitetit rajonal të zhvillimit të turizmit përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin.

## KREU IV
## PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

### Neni 21
### Parimet e planifikimit të zhvillimit të turizmit

1. Planifikimi i zhvillimit të turizmit:

a) mbështetet në Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike;

b) është pjesë përbërëse dhe hartohet në përputhje me planin kombëtar të territorit, me strategjinë e turizmit dhe me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit si dhe me dispozitat e legjislacionit për administrimin dhe mbrojtjen e tokës;

c) përqendrohet në zona me potencial më të madh turistik dhe në ato drejtime ku zhvillimi i turizmit mundëson një ristrukturim social dhe ekonomik.

2. Planet e zhvillimit të turizmit shqyrtohen dhe rishikohen në mënyrë periodike, për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me politikat e zhvillimit kombëtar, territorial, mjedisor dhe ato social-ekonomike të komunitetit.

### Neni 22
### Klasifikimi i burimeve turistike

1. Burimet turistike në Republikën e Shqipërisë klasifikohen në:

a) burime natyrore turistike, ku përfshihen peizazhet natyrore, zonat e mbrojtura, veçoritë gjeografike e biologjike, kushtet klimatike, detare, hidrografike dhe objektet e tjera fizike, natyrore apo gjeomonumentale, që janë tërheqëse për turistët;

b) burime njerëzore turistike, të cilat ndahen në:

i) burime materiale njerëzore turistike, ku përfshihen ndërtesat historike e ndërtimet e tjera, reliket si dhe punët artizanale;

ii) burime jomateriale njerëzore turistike, ku përfshihen veprimtaritë e ndryshme kulturore.

2. Burimet turistike shndërrohen në produkte turistike në bazë të një procesi studimi dhe planifikimi, sipas prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit.

### Neni 23
### Regjistri Kombëtar i Burimeve Turistike

1. Ministria përgjegjëse për turizmin identifikon dhe inventarizon burimet turistike nëpërmjet sigurimit të të dhënave të lidhura me to.

2. Ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me organet publike të qeverisjes qendrore dhe vendore, harton dhe administron Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike, si pjesë e sistemit të bazës së të dhënave.

3. Pronarët ose organet përgjegjëse për administrimin e burimeve turistike duhet të regjistrojnë burimet turistike në Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike.

4. Ministria përgjegjëse për turizmin monitoron përditësimin e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike.

### Neni 24
### Përgjegjësia për administrimin e burimeve turistike

1. Personat juridikë dhe fizikë, organet publike qendrore e vendore apo personat privatë, që zotërojnë ose administrojnë burime turistike, janë përgjegjës për administrimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të lidhura me të.

2. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për bashkërendimin e veprimtarive të organeve publike, të angazhuara në zhvillimin e turizmit brenda territorit të tyre, për mbrojtjen, rritjen dhe përdorimin e burimeve turistike, për shndërrimin e tyre në produkte turistike, duke maksimizuar potencialin e tyre ekonomik, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe me sugjerimet që rrjedhin nga takimet e komitetit rajonal të zhvillimit të turizmit.

Neni 25

**Mbështetja për zhvillimin e turizmit**

Organet shtetërore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për turizmin, ndihmojnë në zhvillimin e turizmit duke:

a) nxitur dhe mbështetur planet e zhvillimit të turizmit për çdo bashki, në bazë të studimeve paraprake, në përputhje me planin kombëtar sektorial të turizmit, për zhvillimin e produktit turistik në atë zonë;

b) dhënë informacionin e nevojshëm turistik;

c) ndihmuar në kualifikimin e burimeve njerëzore;

ç) promovuar produktet turistike të zonës;

d) marrë masa për zhvillimin e infrastrukturës së përgjithshme turistike dhe të shërbimeve publike në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit dhe destinacionet turistike;

dh) mbështetur investimet në turizëm në zonat e thella malore dhe me popullsi të rrallë;

e) propozuar politika të lehtësive për bizneset turistike, për individët dhe subjektet juridike në zonat e rëndësisë kombëtare për turizmin.

Neni 26

**Përgatitja e planit kombëtar sektorial të turizmit**

Ministria përgjegjëse për turizmin, me cilësinë e autoritetit kombëtar sektorial të planifikimit të territorit, përgatit planin kombëtar sektorial të turizmit për gjithë territorin, në përputhje me parashikimet e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe të dispozitave të legjislacionit që rregullojnë veprimtarinë mbi territorin, ku kërkohet të realizohen këto plane zhvillimi.

Neni 27

**Përmbajtja e planit kombëtar sektorial të turizmit**

Plani kombëtar sektorial i turizmit përgatitet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe duhet të përmbajë:

a) parashikimet për zhvillimin e turizmit dhe përcaktimin e zonave të veçanta për këtë qëllim;

b) vlerësimin e kapitalit të investimeve të planifikuara, në përputhje me planet në nivel kombëtar dhe vendor, për një periudhë prej 5 vjetësh, 10 vjetësh ose më gjatë;

c) parashikimet e planit të punimeve në infrastrukturën e zonës, të destinacioneve turistike, në përputhje me potencialin turistik, vlerësimin e rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura dhe planet e zhvillimit social-ekonomik kombëtar, rajonal dhe vendor;

ç) parashikimet e veprimtarive të marketingut;

d) parashikimet e veprimtarive arsimuese, të kualifikimit profesional dhe të edukimit në vazhdim.

Neni 28

**Caktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit**

Me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, Këshilli Kombëtar i Territorit miraton zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si zona të rëndësisë kombëtare, në përputhje me planin e përgjithshëm kombëtar dhe planin kombëtar sektorial të turizmit.

Neni 29

**Mbrojtja, ruajtja, përdorimi dhe zhvillimi i burimeve natyrore turistike**

1. Me qëllim mbrojtjen, ruajtjen, përdorimin dhe zhvillimin me efikasitet të burimeve natyrore turistike, zhvillimi dhe operimi i një sipërmarrjeje turistike, si hotel, kompleks turistik dhe struktura të tjera akomoduese, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, bëhet në përputhje me planin kombëtar sektorial të turizmit, kategoritë e klasifikimit dhe të planeve të menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe me parashikimet ligjore në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe duke iu referuar dokumenteve të planifikimit.

2. Zhvillimi dhe operimi i një sipërmarrjeje turistike, si hotel, kompleks turistik dhe struktura të tjera akomoduese, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, bazuar në interesin e përgjithshëm publik, mund të bëhet edhe në pronat shtetërore, me kusht që këto struktura, ndërtime, mjedise e shërbime ndihmëse të mos dëmtojnë parametrat natyrorë dhe kulturorë të këtyre zonave dhe të mos rrezikojë aktivitetin turistik, e të jenë në përputhje me planin kombëtar sektorial të turizmit.

3. Shfrytëzimi i burimeve natyrore si det, liqen, lumë apo brigjet e tyre duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të mos dëmtojë apo shkatërrojë, në asnjë rast, karakteristikat e tyre dhe territorin buzë tyre.

### Neni 30
**Plani i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit**

1. Ministria përgjegjëse për turizmin përgatit planin e zhvillimit dhe të veprimit për çdo zonë me përparësi zhvillimin e turizmit, në bashkëpunim me ministritë, organet publike, organet e qeverisjes vendore, si dhe me grupet e interesit, dhe e paraqet për miratim, sipas parashikimeve të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe mbështetur në dokumentet e planifikimit kombëtar e vendor.

2. Planet e detajuara për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit hartohen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" e rregullores së planifikimit dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

3. Ministria përgjegjëse për turizmin, në cilësinë e autoritetit të planifikimit, zbaton instrumentet për drejtimin e zhvillimit, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. Planet e zhvillimit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, përveç sa është parashikuar në rregulloren e planifikimit, përmbajnë edhe:

a) identifikimin, vlerësimin dhe klasifikimin e burimeve turistike të disponueshme në këto zona;

b) analizimin e mjedisit ekzistues turistik dhe të potencialit të tij, përfshirë mjedisin natyror, të biodiversitetit, të peizazhit dhe të rrjetit të zonave të mbrojtura, si dhe mjedisin kulturor, ekonomik e social;

c) përcaktimin e prioriteteve në zhvillimin e zonave përkatëse;

ç) përcaktimin dhe përshkrimin e zonave të planifikuara për turizëm, të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe të nevojave të tyre për zhvillim turistik, brenda zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;

d) infrastrukturën e nevojshme për sistemin e ujësjellësit, sistemin e kanalizimeve, furnizimit me energji, internet, mjediset publike dhe shërbimet turistike, që kërkohen për përmirësimin e potencialit turistik të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;

dh) planifikimin e sinjalistikës, stendat dhe afishimeve turistike, në bashkërendim me organet publike përgjegjëse;

e) përcaktimin e mjeteve të mbrojtjes dhe të promovimit të produkteve turistike me vlerë trashëgimie kulturore, historike ose natyrore dhe specifikimin e formave dhe mekanizmave të nevojshëm të bashkëpunimit dhe të bashkërendimit me autoritetet kompetente, për të arritur këtë objektiv;

ë) përcaktimin e mjeteve të nxitjes dhe promovimit të turizmit pritës dhe identifikimin e programeve të qarta të punës për ta realizuar këtë;

f) përcaktimin e mjeteve të zhvillimit dhe të mbështetjes së produkteve të turizmit në të gjitha format e tyre;

g) përcaktimin e nevojave për financim, me qëllim zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit turistik;

gj) përcaktimin e burimeve të nevojshme njerëzore për zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit;

h) parashikimin për monitorimin e zbatimit të planit kombëtar sektorial të turizmit dhe ndjekjen e vlerësimit të performancës në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

## KREU V
## MBËSHTETJA FINANCIARE E PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT

### Neni 31
**Mbështetja financiare për projektet në fushën e turizmit**

1. Ministria përgjegjëse për turizmin përgatit programe për mbështetjen e projekteve në fushën e turizmit.

2. Këto programe duhet të jenë në përputhje me objektivat e këtij ligji dhe të sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, të mbrojnë, të ruajnë dhe të promovojnë destinacionet turistike dhe vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, të mundësojnë zhvillimin dhe diversifikimin e produkteve turistike, si dhe të mbështetin profesionalizmin në fushën e turizmit.

3. Ministria përgjegjëse për turizmin, nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit, financon projekte edukimi, promovimi dhe studime apo modele produktesh turistike në ndihmë të zhvillimit të turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj.

4. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.

5. Projektet, të cilat kërkojnë një financim, që arrin mbi 50 për qind të fondit vjetor të parashikuar

për projektet turistike, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Miratimi i projekteve turistike bëhet nga ministri përgjegjës për turizmin, me propozim të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve, të përbërë nga 7 anëtarë:

a) 5 nëpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të strukturave përgjegjëse në ministri;

b) 2 përfaqësues nga shoqatat e sektorit të turizmit.

7. Anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë-propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në pikën 3, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 32

**Kompetencat e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve**

1. Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve ka këto kompetenca:

a) klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit, duke vlerësuar ndikimin social-ekonomik të tyre;

b) propozon miratimin e projekteve, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji.

2. Mënyra e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

KREU VI

INVESTIMET NË TURIZËM

Neni 33

**Format e partneritetit**

1. Në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit shteti mund të marrë rolin e zhvilluesit, të përfshihet në partneritete publiko-private, të përfaqësohet me aksione në sipërmarrje turistike, të vërë në dispozicion pasuri të paluajtshme, të sigurojë infrastrukturë mbështetëse etj., si dhe kombinime të formave të mësipërme.

2. Për aq sa nuk përcaktohet me këtë ligj, format e partneritetit rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 34

**Pasuritë e paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit**

1. Pasuritë e paluajtshme, në pronësi të shtetit, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me përjashtim të zonave të mbrojtura dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 2 muajve nga miratimi i zonës, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Pasuritë e paluajtshme, në administrim të njësive të qeverisjes vendore, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 2 muajve nga miratimi i zonës, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

3. Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, miraton me vendim të veçantë transferimin, në favor të shtetit, të pasurive të paluajtshme në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Neni 35

**Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore**

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, miraton vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për projekte investuese në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

2. Kohëzgjatja e vënies në dispozicion është deri në 99 vjet.

3. Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore mund të bëhet edhe nëpërmjet kontratës simbolike 1 euro.

4. Rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Në rastin e investitorëve me status Investitor Strategjik i Veçantë, sipas përcaktimeve në legjislacionin për investimet strategjike, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, rast pas rasti, transferimin e së drejtës së pronësisë të pasurive të paluajtshme shtetërore tek investitori privat, duke e kushtëzuar kalimin me realizimin e plotë të investimit. Kur vlerësohet nga Këshilli i Ministrave, marrëveshja për realizimin e investimit strategjik propozohet për miratim me ligj të posaçëm në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 36
### Marrëveshja me investitorin

1. Ministria përgjegjëse për turizmin nënshkruan marrëveshje zhvillimi me investitorët, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në të cilat parashikohen angazhimet reciproke, karakteristikat, afatet e realizimit dhe vlera e projektit, si dhe garancitë e nevojshme dhe instrumentet e sigurisë për realizimin e investimit.

2. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat dhe formatet e marrëveshjeve me investitorët.

### Neni 37
### Portet turistike

1. Ministria përgjegjëse për turizmin mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave shpalljen e porteve turistike apo pontileve të përhershme, që shërbejnë si infrastrukturë mbështetëse për strukturat turistike.

2. Këshilli i Ministrave, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, autorizon ndërtimin dhe operimin nga investitorët e strukturave turistike të porteve dhe pontileve të shpallura sipas pikës 1 të këtij neni.

### Neni 38
### Të drejtat dhe detyrimet e investitorit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit

1. Investitori është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet dhe të sigurojë të gjitha garancitë, financiare apo të çdo lloji, siç përcaktohet në marrëveshjen e nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për turizmin.

2. Investitori zgjedh format e përshtatshme të administrimit dhe të ofrimit të produkteve turistike, përfshirë timeshare etj.

3. Investitori gëzon të drejtën e nënkontraktimit të ndërtimit të strukturave apo të administrimit të sipërmarrjes, apo pjesëve të saj, me kusht që objekti i veprimtarisë të mbetet i pandryshuar. Në çdo rast, investitori mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të marrëveshjes së nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për turizmin.

4. Investitori mund të transferojë pronësinë e strukturave të veçanta akomoduese tek të tretët. Transferimi bëhet vetëm me miratimin e ministrit përgjegjës për turizmin. Strukturat që parashikohet të transferohen paraqiten të detajuara në projektin e investimit dhe lejimi i transferimit të tyre miratohet si aneks i veçantë i marrëveshjes me investitorin.

5. Transferimi i veprimtarisë, si e tërë apo i një pjese të aksioneve tek të tretët, bëhet vetëm me miratimin e ministrit përgjegjës për turizmin, me kusht që objekti i veprimtarisë të mbetet i pandryshuar.

### Neni 39
### Shfuqizimi i vënies në dispozicion

1. Në rast mospërmbushjeje apo shkeljeve të dispozitave të marrëveshjes së zhvillimit, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, mund të shfuqizojë të drejtën e fituar të vënies në dispozicion të pasurisë së paluajtshme.

2. Marrëveshja parashikon garanci dhe penalitete specifike ndaj investitorit për kompensimin e interesave të shtetit dhe të të tretëve në rastet e shfuqizimit.

### Neni 40
### Përdorimi i bregut

1. Për investimet pranë brigjeve të detit apo liqenit mund të vihet në dispozicion një hapësirë e plazhit, në raport me kapacitetin e strukturës akomoduese.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e detajuara për zbatimin e pikës 1 të këtij neni.

### Neni 41
### Zonat ku nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar

1. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme kryen regjistrim të veçantë për të gjitha pasuritë që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, për të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar.

2. Regjistrimi i veçantë, sipas pikës 1, kryhet brenda 3 muajve nga miratimi i zonës me përparësi zhvillimin e turizmit.

### Neni 42
### Investimet jashtë zonave me përparësi zhvillimin e turizmit

Autoritetet vendore të planifikimit, pasi miratojnë lejet e ndërtimit për struktura akomoduese jashtë zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, njoftojnë ministrinë përgjegjëse për turizmin.

KREU VII
STRUKTURAT AKOMODUESE

Neni 43

**Kategoritë e strukturave akomoduese**

Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a) “Bujtinë” ; b) “Fjetinë” (Hostel); c) “Kamping”; ç) “Hotel”; d) “Motel”; dh) “Resort”; e) “Qendër kurative”; ë) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Neni 44

**Kriteret e ndërtimit të strukturave akomoduese**

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, miraton rregulloren përkatëse për kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese.

Neni 45

**Klasifikimi i strukturave akomoduese**

1. Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Bujtinë”Standard;

“Fjetinë”Standard, Komfort;

“Kamping”Standard

“Hotel”Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;

“Motel”Standard, Komfort, Superior;

“Resort” Tre yje, katër yje, pesë yje;

“Qendër kurative” Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;

“Fjetje dhe mëngjes” (B&B)Standard, Komfort, Superior.

2. Çdo sipërmarrje turistike, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë klasifikimi, sipas kritereve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese.

3. Certifikata e klasifikimit është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rinovimi brenda 30 ditëve nga afati i mbarimit të vlefshmërisë së saj.

4. Riklasifikimi i strukturës akomoduese, përpara periudhës së mbarimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës së klasifikimit, me qëllim ngritjen e nivelit të klasifikimit, bëhet me kërkesë të subjektit.

5. Kushtet, kriteret, tarifat, afatet, si dhe procedura për klasifikimin e strukturave akomoduese, përcaktohen me rregulloren përkatëse, që miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

6. Ministria përgjegjëse për turizmin bashkëpunon me agjenci dhe organizata të mirënjohura ndërkombëtare për hartimin e rregullores dhe klasifikimin e strukturave akomoduese.

7. Kostoja e procesit të klasifikimit mbulohet nga sipërmarrjet turistike që certifikohen.

8. Certifikata e klasifikimit regjistrohet automatikisht, pas përfundimit të procesit të klasifikimit në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

9. Për çdo ndryshim të të dhënave të deklaruara, sipërmarrja turistike që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e strukturave akomoduese, duhet të njoftojë strukturën përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, brenda 7 ditëve pune.

10. Nuk i nënshtrohen procesit të klasifikimit të strukturave akomoduese, sipas parashikimeve të këtij ligji, strukturat akomoduese që përbëjnë objekt të veçantë të trashëgimisë kulturore, të përcaktuara nga ligji.

Neni 46

**Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së strukturës akomoduese**

Sipërmarrja turistike, që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e strukturave akomoduese, e humbet të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë:

a) me përfundimin e aktivitetit si person fizik/juridik;

b) kur i hiqet kjo e drejtë me vendim të komisionit të standardizimit të veprimtarive turistike, pasi nuk plotëson kushtet dhe kriteret e nivelit më të ulët të sistemit të klasifikimit;

c) sipas përcaktimeve të tjera të bëra në këtë ligj.

## KREU VIII
## AGJENCITË E UDHËTIMIT DHE OPERATORËT TURISTIKË

### Neni 47
### **Agjencia e udhëtimit**

Shërbimet e agjencisë së udhëtimit përfshijnë, por nuk kufizohen me:

a) shitjen e biletave të avionit, të tragetit, të trenit, të autobusit;

b) shitjen e paketave të udhëtimit, në emër të operatorëve të udhëtimit, vendas ose ndër-kombëtarë;

c) dhënien e automjeteve me qira, në emër të përfaqësuesve të automjeteve me qira;

ç) përgatitjen e dokumenteve të udhëtimit, në përputhje me rregullat në fuqi;

d) dhënien e informacionit të duhur dhe ndihmës për lëshimin e certifikatës për vaksinimin, në rastet e udhëtimit në vende me rrezik epidemiologjik;

dh) dhënien e informacionit të duhur dhe ndihmës për lëshimin e vizave dhe dokumenteve të tjera të domosdoshme për hyrjen në një vend të caktuar;

e) përgatitjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme për transportin dhe/ose akomodimin e udhëtarëve.

### Neni 48
### **Licencimi dhe rregullat për ushtrimin veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit**

1. Agjencia e udhëtimit, para fillimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie, pajiset me licencë, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 16, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Agjencia e udhëtimit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimeve, me objekt veprimtarie si agjenci udhëtimi;

b) përfaqësuesi ligjor të mos jetë një person i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të mashtrimit, të mospagimit të taksave dhe tatimeve, të korrupsionit, apo për një vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit të personit, brenda një periudhe 5-vjeçare, që i paraprin kërkesës për licencë;

c) përfaqësuesi ligjor (administratori) ose drejtuesi teknik të zotërojnë një diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve ose dëshmi kualifikimi profesional, në përputhje me objektin e veprimtarisë së biznesit;

ç) të zotërojë një mjedis pune jo më të vogël se 10 m2 për ushtrimin e veprimtarisë;

3. Kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit përcaktohen në rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Pas publikimit të licencës në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, ministria përgjegjëse për turizmin bën regjistrimin e kësaj licence në Regjistrin Qendror të Turizmit.

### Neni 49
### **Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit**

Revokimi i licencës dhe ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit bëhet sipas përcaktimeve të neneve 12 e 29, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

### Neni 50
### **Operatori turistik**

Operatori turistik e bën shitjen e produkteve të veta turistike, kryesisht, nëpërmjet agjencive të udhëtimit, pa u kufizuar edhe me shitjen e drejtpërdrejtë te konsumatori. Ai nënshkruan kontrata të drejtpërdrejta me furnizuesit e shërbimeve turistike, duke i parablerë këto shërbime.

### Neni 51
### **Licencimi dhe rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve turistikë**

1. Operatori turistik, para fillimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie, pajiset me licencë, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 16, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Operatori turistik duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimeve, me objekt veprimtarie si operator turistik;

b) përfaqësuesi ligjor të mos jetë një person i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të mashtrimit, të mospagimit të taksave dhe tatimeve, të korrupsionit, apo për një vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit të personit, brenda një periudhe 5-vjeçare, që i paraprin kërkesës për licencë;

c) përfaqësuesi ligjor (administratori) dhe drejtuesi teknik të zotërojnë një diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve, në përputhje me objektin e veprimtarisë së biznesit dhe të kenë një eksperiencë të mëparshme në këtë fushë;

ç) të zotërojë një mjedis pune jo më të vogël se 16 m2 për ushtrimin e veprimtarisë.

3. Kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik përcaktohen në rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

4. Pas publikimit të licencës në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, ministria përgjegjëse për turizmin bën regjistrimin e kësaj licence në Regjistrin Qendror të Turizmit.

Neni 52

**Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së operatorit turistik**

Revokimi i licencës dhe ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së operatorit turistik bëhet sipas përcaktimeve të neneve 12 e 29, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 53

**Regjistrimi i udhëtimeve**

1. Agjencia e udhëtimit dhe operatori turistik mban regjistër me të dhënat e turistëve, destinacionet e vizituara dhe ditët e qëndrimit dhe i raporton këto të dhëna elektronikisht, një herë në muaj, sipas formularit të miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

2. Një agjenci udhëtimi ose operator turistik duhet t’i ruajë këto raportime, të specifikuara, për tre vjet, nga data e kthimit nga udhëtimi përkatës.

Neni 54

**Të dhënat bazë të kontratës me konsumatorin**

1. Të dhënat bazë të kontratës së operatorëve turistikë dhe agjencive të udhëtimit me konsumatorin duhet të përmbajnë, të paktën:

a) licencën e “Operatorit turistik”;

b) emrin, adresën dhe të dhëna të tjera kontakti të agjencisë së udhëtimit, operatorit turistik dhe të siguruesit;

c) destinacionin e udhëtimit dhe datat e nisjes e të kthimit;

ç) mjetin e transportit të përdorur;

d) itinerarin e udhëtimit;

dh) tipin e strukturës së akomodimit, vendndodhjen, klasifikimin dhe karakteristikat kryesore të saj;

e) vaktet e ushqimit, të përfshira në çmimin e paguar;

ë) listën e shërbimeve të tjera që ofrohen për klientët brenda çmimit të paguar;

f) listën e shërbimeve që nuk përfshihen në çmimin e paguar;

g) listën e shërbimeve shtesë, që mund të blihen veçmas;

gj) numrin minimal të personave të domosdoshëm për realizimin e paketës së udhëtimit;

h) afatin për njoftimin e klientit, në rastin e anulimit nga ana e operatorit turistik;

i) afatet dhe penalitetet përkatëse, në rastin e anulimit të shërbimit të blerë nga ana e klientit;

j) mundësinë e transferimit të paketës;

k) çmimin e paketës së udhëtimit dhe kur paketa lejon rishikim çmimi, një shënim për rishikimin e mundshëm dhe mënyrën e përllogaritjes së këtij rishikimi;

l) tabelën me afatet kohore dhe mënyrën e pagesave;

ll) kërkesat e veçanta që klienti ka bërë me dije në momentin e rezervimit dhe për të cilat është rënë dakord nga të dyja palët;

m) përgjegjësitë që dalin nga mospërmbushja e detyrimeve në dëm të klientit;

n) formatin e garancisë, shtrirjen dhe limitet financiare të përgjegjësisë;

nj) detyrimin e përfaqësuesit të huaj për të komunikuar me klientin nëpërmjet operatorit turistik;

o) detyrimin e përfaqësuesit të huaj për të ndihmuar në çdo rast.

2. Sipërmarrjet turistike të udhëtimit, për sa u takon paketave të udhëtimit, zbatojnë detyrimet e parashikuara në kuadrin ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 55

**Garancitë e operatorëve turistikë**

1. Operatorët turistikë duhet të kenë një kontratë të vlefshme sigurimi për mbulimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta, si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve, përfshirë aftësinë paguese dhe falimentimin. Kontrata e Sigurimit lidhet me një shoqëri sigurimi, në përputhje me dispozitat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për sigurimet dhe risigurimet.

2. Kontrata e sigurimit duhet të mbulojë dëmet e parashikuara më sipër, si dhe ato të parashikuara në kuadrin ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.

KREU IX

UDHËRRËFYESI TURISTIK

Neni 56

**Kategoritë e udhërrëfyesit turistik në Republikën e Shqipërisë**

Udhërrëfyesi turistik në Republikën e Shqipërisë ndahet në kategoritë e mëposhtme:

a) udhërrëfyes turistik kombëtar, personi, i cili mund të udhëheqë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) udhërrëfyes turistik lokal, personi, i cili mund të udhëheqë vetëm në një zonë të kufizuar;

c) udhërrëfyes i specialitetit të veçantë, personi, i cili mund të udhëheqë veprimtari të turizmit të aventurës dhe të interesit të veçantë.

Neni 57

**Kriteret për certifikimin e udhërrëfyesit turistik**

1. Veprimtaria e udhërrëfyesit lejohet për t’u ushtruar, pas pajisjes së këtij të fundit me certifikatë.

2. Kriteret për pajisjen me certifikatë, për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodi i etikës së tyre, parashikohen në rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ministria përgjegjëse për turizmin lëshon certifikatën e udhërrëfyesit turistik për kategorinë dhe gjuhën përkatëse të udhërrëfyesit.

4. Certifikata që miraton kryerjen e shërbimit të udhërrëfyesit turistik regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin .

5. Certifikata e udhërrëfyesit turistik duhet të përmbajë:

a) emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, adresën e udhërrëfyesit turistik;

b) kategorinë e udhërrëfyesit turistik;

c) territorin ku do të ushtrojë veprimtarinë si udhërrëfyes turistik, sipas kategorisë përkatëse;

ç) gjuhën në të cilën ai do të ushtrojë veprimtarinë si udhërrëfyes turistik;

d) datën e lëshimit të certifikatës.

6. Afati i vlefshmërisë së certifikatës së udhërrëfyesit turistik është 2 vjet nga data e lëshimit, me të drejtë rinovimi.

Neni 58

**Dokumenti identifikues i një udhërrëfyesi turistik**

1. Një udhërrëfyes turistik i certifikuar do të pajiset me dokument identifikues zyrtar, që tregon se ai është i certifikuar për të vepruar si udhërrëfyes turistik. Dokumenti identifikues i pajisur me të dhënat e përcaktuara në pikën 5, të nenit 57, përgatitet nga struktura përkatëse në ministri dhe i dorëzohet subjektit bashkë me certifikatën.

2. Udhërrëfyesi turistik duhet ta mbajë dokumentin identifikues zyrtar në një vend të dukshëm të veshjes së vet, gjatë gjithë kohës që kryen shërbimet si udhërrëfyes turistik.

3. Nëse dokumenti identifikues i udhërrëfyesit turistik dëmtohet, shkatërrohet ose humbet, ky i fundit duhet të aplikojë pranë strukturës përgjegjëse në ministri për t’u pajisur me një dokument të ri identifikues.

4. Nëse një dokument identifikues i dëmtuar zëvendësohet me një të ri, udhërrëfyesi turistik, me marrjen e dokumentit të ri, duhet të kthejë të vjetrin.

5. Në rastet e pezullimit, heqjes ose pavlefshmërisë së certifikatës së udhërrëfyesit turistik, ky i fundit duhet ta kthejë dokumentin identifikues pranë strukturës përgjegjëse në ministri, brenda 5 ditëve.

Neni 59

**Rinovimi i certifikatës së udhërrëfyesit turistik**

Rinovimi i certifikatës së udhërrëfyesit turistik bëhet nga ministria përgjegjëse për turizmin, në bazë të sistemit të krediteve të programit për edukimin profesional në vazhdim, të miratuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me institucionet e akredituara prej saj për realizimin e këtij programi.

Neni 60

**Edukimi profesional në vazhdim i udhërrëfyesve turistikë**

Ministria përgjegjëse për turizmin nxit, mbështet dhe bashkëpunon me institucionet e akredituara prej saj për organizimin e kurseve të vazhdueshme të edukimit profesional dhe të seminareve informuese për udhërrëfyesit turistikë, me qëllim ruajtjen e standardeve të shërbimit të udhërrëfimit turistik, për të përditësuar dhe pasuruar njohuritë e udhërrëfyesit turistik me të dhëna të reja, duke përmirësuar, në mënyrë të vazhdueshme, cilësinë e këtij shërbimi.

Neni 61

**Udhërrëfyesi turistik i huaj**

1. Udhërrëfyesi turistik i huaj, i cili nuk është i certifikuar në Republikën e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, mund të shoqërojë grupe vizitorësh apo turistësh të huaj, për qëllime turistike, në territorin e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e shoqëruesit të udhëtimit. Ai duhet të ketë si shoqërues një udhërrëfyes turistik të certifikuar, sipas parashikimeve të këtij ligji, në bazë të një kontrate shërbimi, i cili duhet të jetë prezent gjatë vizitës të grupit të huaj në territorin shqiptar.

2. Në rastin kur një shtetas i huaj do të ushtrojë profesionin e udhërrëfyesit turistik në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç përmbushjes së kritereve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 57, të këtij ligji, ai duhet edhe të jetë rezident, për jo më pak se një vit, në Republikën e Shqipërisë dhe të ketë njohuri bazë të gjuhës shqipe.

Neni 62

**Udhërrëfyesi turistik i nderit**

1. Shkencëtarëve të shquar dhe ekspertëve nga fusha të caktuara si dhe profesionistëve në fushën e udhërrëfyesve, të dalë në pension, mund t'u njihet cilësia e udhërrëfyesit turistik të nderit.

2. Udhërrëfyesi turistik i nderit mund të ushtrojë veprimtarinë e udhërrëfyesit turistik vetëm përkohësisht.

3. Kushtet dhe mënyra e njohjes së udhërrëfyesit turistik të nderit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

KREU X

TRANSPORTI TURISTIK DHE SIPËRMARRJET E TJERA TURISTIKE

Neni 63

**Transporti turistik**

1. Veprimtaria e transportit turistik ushtrohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë fushën e transportit.

2. Ministri përgjegjës për turizmin, së bashku me ministrin përgjegjës për transportin, përcaktojnë, me udhëzim të përbashkët, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet në fushën e transportit turistik.

Neni 64

**Stacionet e plazhit**

1. Ushtrimi i veprimtarisë së stacionit të plazhit ushtrohet bazuar në një kontratë përdorimi për hapësirën e plazhit të vënë në dispozicion, të lidhur midis subjektit dhe autoritetit publik kompetent.

2. Rregullorja për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Verifikimi dhe kontrolli i përmbushjes së kritereve të përcaktuara kryhet nga autoritetet publike kompetente dhe inspektorati që mbulon fushën e turizmit.

KREU XI

STATISTIKAT

Neni 65

**Parimet bazë**

1. Mbledhja e të dhënave statistikore bëhet në përputhje me parimet e paanshmërisë, të besueshmërisë, transparencës, ruajtjes së konfidencialitetit

dhe mbrojtjes së të dhënave, bazuar në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004, "Për statistikat zyrtare", të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, sipas metodologjisë së përcaktuar nga autoritetet përgjegjëse për statistikat zyrtare, me qëllim për të studiuar ecurinë e zhvillimit të turizmit në nivel të përgjithshëm kombëtar.

2. Struktura që merret me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga strukturat akomoduese, operatorët apo agjencitë e udhëtimit, është përgjegjëse për ruajtjen e konfidencialitetit të këtyre të dhënave dhe përpunimi dhe komunikimi i tyre bëhet vetëm në linjë vertikale dhe në mënyrë të përgjithshme.

Neni 66

**Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore**

1. Struktura përgjegjëse për të dhënat statistikore, në ministrinë përgjegjëse për turizmin, siguron të dhëna mujore nga:

a) strukturat akomoduese, për numrin e vizitorëve, numrin e netëve të qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën;

b) operatorët turistikë apo agjencitë e udhëtimit, për numrin total të vizitorëve për turizmin pritës dhe turizmin në dalje, shtetësinë dhe destinacionin.

2. Të dhënat e raportuara nga subjektet e përmendura, sipas pikës 1, të këtij neni, ruhen nga këto subjekte për një afat trevjeçar.

KREU XII

EDUKIMI NË FUSHËN E TURIZMIT

Neni 67

**Objektivat e edukimit në fushën e turizmit**

Ministria përgjegjëse për turizmin nxit edukimin në fushën e turizmit me objektivat e mëposhtëm:

a) nxitja dhe edukimi i të gjitha shtresave të popullsisë për turizmin si industri, njohjen e historisë, kulturës, bukurive natyrore, traditave fetare, artizanatit dhe vënien e tyre në shërbim të turizmit, duke bashkëpunuar me ministritë përgjegjëse dhe me institucione të tjera publike e private, që veprojnë në fushat përkatëse;

b) rritja e ndërgjegjësimit social për turizmin, krijimi i një mjedisi të hapur e miqësor për turistët dhe zhvillimi i traditës së mikpritjes.

Neni 68

**Edukimi, trajnimi dhe puna kërkimore**

1. Ministria përgjegjëse për turizmin nxit dhe fuqizon kapacitetet njerëzore të sektorit të turizmit, përmes:

a) përfshirjes në fushata për nxitjen e ndërgjegjësimit në popullatën e gjerë për kontributin e sektorit të turizmit në ekonominë vendase, përfitimet e tjera pozitive dhe mundësitë që sektori ofron për punësimin dhe zhvillimin profesional;

b) përfshirjes së çështjeve të turizmit, si sektor i rëndësishëm ekonomik, në të gjitha ciklet e sistemit arsimor;

c) nxitjes së kurseve të trajnimit profesional në shkolla dhe qendra të formimit profesional për sektorin e turizmit;

ç) dhënies së çmimeve kombëtare të suksesit apo të ekselencës, për shërbimet në fushën e turizmit, sipërmarrjeve turistike apo individëve të veçantë.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për turizmin, akrediton kurset e trajnimit profesional për sektorin e turizmit.

KREU XIII

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 69

**Përmbajtja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit**

Bashkëpunimi ndërkombëtar nxitet në fushat e mëposhtme:

a) studimi bazë, mbrojtja, eksplorimi dhe zhvillimi i burimeve turistike;

b) zhvillimi i produkteve turistike;

c) marketimi në fushën e turizmit;

ç) pjesëmarrja në programe të përbashkëta të organizatave rajonale dhe ndërkombëtare turistike;

d) zhvillimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve në fushën e turizmit;

dh) kërkimet shkencore e aplikimet e teknologjisë së përparuar dhe zbatimi në fushën e turizmit;

e) shkëmbimi i ekspertëve, informacionit dhe përvojës për zhvillimin e turizmit;

ë) mbrojtja e mjedisit dhe vlerave të trashë-gimisë kulturore dhe natyrore në zonat me përpa-

rësi zhvillimin e turizmit, destinacionet turistike;

f) hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar Sektorial për zhvillimin e turizmit.

Neni 70

**Marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare të turizmit**

1. Ministria përgjegjëse për turizmin përfaqëson Shqipërinë në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të turizmit.

2. Shoqatat dhe sipërmarrjet turistike shqiptare kanë të drejtën të aderojnë në shoqatat ndërkombëtare të turizmit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

KREU XIV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 71

**Rastet e kundërvajtjeve administrative**

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

a) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat dhe kriteret e përcaktuara sipas parashikimeve të nenit 44, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

b) përdorimi i paautorizuar i shenjave dalluese të klasifikimit, sipas nenit 45, dënohet me gjobë 150 000 lekë;

c) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 48, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

ç) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 51, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

d) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2, të nenit 53, dënohet me gjobë 50 000 lekë;

dh) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 54, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

e) ushtrimi i veprimtarisë pa certifikatë, sipas pikës 1, të nenit 57, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

ë) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 58, dënohet me gjobë 50 000 lekë;

f) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 61, dënohet me gjobë 150 000 lekë;

g) ushtrimi i veprimtarisë pa kontratën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 64, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

2. Procedurat e konstatimit, vendosjes, ankimit dhe ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Subjektet e gjobitura duhet të paguajnë gjobën brenda 10 ditëve nga data kur vendimi i dënimit me gjobë është bërë titull ekzekutiv.

Neni 72

**Ankimi**

1. Ankimi administrativ, në lidhje me gjobat, do të bëhet në përputhje me përcaktimet në dispozitat e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

2. Ankimi administrativ, në lidhje me licencat, do të bëhet në përputhje me përcaktimet në dispozitat e ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 73

**Të ardhurat nga vendosja e gjobave**

Të ardhurat e krijuara nga vendosja e gjobave derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

KREU XV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 74

**Dispozita kalimtare**

1. Sipërmarrjet turistike, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si struktura akomoduese dhe që e kanë filluar veprimtarinë e tyre para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të aplikojnë për marrjen e certifikatës brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, të cilët kanë filluar ushtrimin e veprimtarisë së tyre para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet:

a) të aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit për pajisjen me licencë brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) përveç sa është parashikuar në pikën 3, të nenit 48, dhe në pikën 3, të nenit 51, sipërmarrja turistike, që ushtron veprimtarinë si agjenci udhëtimi dhe operator turistik, duhet të plotësojë dhe kriteret e mëposhtme:

i) të mos jetë në proces falimentimi;

ii) të mos jetë në proces likuidimi.

3. Masa dhe mënyra e përdorimit të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 75

**Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 12; të pikës 3, të nenit 16; të pikave 5, 7 e 8, të nenit 31; të pikës 4, të nenit 35; të pikës 2, të nenit 36; të pikës 2, të nenit 40; të nenit 44; të pikës 5, të nenit 45; të pikës 3, të nenit 48; të pikës 3, të nenit 51; të pikës 2, të nenit 57dhe të pikës 2, të nenit 64.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për turizmin që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 9;pikës 2, të nenit 10;të pikës 2, të nenit 11; të pikës 4, të nenit 17; të pikave 2 e 3, të nenit 18; të pikës 4, të nenit 20;të pikës 2, të nenit 32;të pikës 1, të nenit 53;tëpikës 3, të nenit 62 dhe të pikës 2 të nenit 63.

Neni 76

**Shfuqizime**

Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007, "Për turizmin", të ndryshuar, dhe çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 77

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

**Ilir Met**a

Miratuar në datën 27.7.2015